

25.01.2022
Ora 16:08

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 2, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në KZAZ dhe KOV”

PJESËMARRJA :

KQZ:

• Komisioni Rregullator:

- | | | |
|------------|-----------|--------------------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y. Merkaj, M. Koja, A. Tahiraj |
| Parti | Politike: | PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj) |

OJQ:

KRIK

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme e martë, 25.01.2022. Rendi i ditës është publikur në faqen e Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, u është njoftuar gjithashtu dhe partive politike. Në rendin e ditës sot kemi për shqyrtim tre projektakte, tre projektvendime.

I pari, për disa shtesa në udhëzimin nr. 2, datë 05.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.01.2022*


shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në KZAZ dhe KQV”.

Pika e dytë në rendin e ditës, projektvendimi “Për një shtesë në vendimin nr. 5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”.

Pika e tretë në rendit të ditës është miratimi i projektvendimit “Për miratimin e udhëzuesit të punës për komisionet e zonave të administrimit zgjedhor, për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022”. Të pranishëm në mbledhje janë të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës. Janë të pranishëm dhe përfaqësues të partive politike. Mbledhja deklarohet e hapur, para se të fillojmë me shqyrtimin e projektakteve në rendin e ditës, pyetja e parë që u drejtohet anëtarëve nëse keni diçka jashtë rendit të ditës për të diskutuar? Nuk kemi! Atëherë fillojmë me rendin e ditës. Projektvendimi i parë është për disa shtesa në udhëzimin nr.2, datë 05.12.2020 të Komisionit Rregullator, “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në KZAZ dhe KQV”. Është përgatitur projektvendimi nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Lutem Sekretarit të Përgjithshëm ose ndonjë zyrtar tjetër për të prezantuar projektaktin! Mesa po shohim dy projektaktet e para janë shtesa që kanë të bëjnë me zgjedhjet e pjesshme për të përcaktuar disa procedura dhe afate.

Z. Y. Merkaç: Presidenti i Republikës me dekretin nr.13438, datë 20.01.2022 ka caktuar në datën 6 Mars 2022 për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje. Referuar përcaktimit të nenit 20, pika 1, shkronja “a” të Kodit Zgjedhor, duke qenë se në udhëzimin nr. 2, datë 05.12.2020 të Komisionit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.01.2022*

Rregullator janë përcaktuar procedurat për zgjedhjen dhe trajnimin e shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancave në KZAZ dhe në KQV, me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve propozojmë të bëjmë disa shtesa dhe ndryshime në këtë udhëzim. Pikërisht pas pikës 3, të nenit 5 të këtij udhëzimi, të shtohet pika 4 me këtë përmbajtje “për zgjedhjet e parakohshme dhe/ose të pjesshme, Komisioneri i Zgjedhjeve me vendim të veçantë përcakton afatet dhe procedurat për emërimin kryesisht të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve”. Gjithashtu pas pikës 3, të nenit 10 të këtij udhëzimi propozohet të shtohet pika 4 me këtë përmbajtje “për zgjedhjet e parakohshme dhe/ose të pjesshme Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim të veçantë përcakton afatet dhe propozon procedurat për emërimin kryesisht të anëtarëve dhe sekretarëve të KQV-ve”. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Znj. I. Nano:–Faleminderit, zoti Merkaj! Fillojmë diskutimin në parim të projektvendimit. Sikundër e patë, të dy shtesat që propozohen, lidhen me përdorimin e këtij mekanizmi që është plotësimi i vakancave nëpërmjet emërimit kryesisht të anëtarëve të KZAZ-ve dhe KQV-ve nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Është një ndryshim në një udhëzim të miratuar më herët. Duke bërë këtë rregullim mundësohet që ky mekanizëm të përdoret në rast nevoje dhe në rastin e zgjedhjeve të pjesshme apo të parakohshme dhe i lihet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të përcaktojë me vendim të veçantë, afatet dhe procedurat. Duke mos përcaktuar një afat konkret, pasi është një normë më gjeneraliste që mund të përdoret në çdo zgjedhje të ardhshme të pjesshme, apo të parakohshme. Kemi diskutime në parim? Përfaqësuesit e partive politike?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.01.2022*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zonja Kryetare! Ne jemi njohur në rrugë elektronike me projektvendimin e dërguar nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Vlerësojmë se është në përputhje me ligjin dhe nuk kemi ndonjë objeksion.

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Logu! Zoti Kaziaj!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Përshëndetje të gjithëve! Nuk kemi ndonjë qëndrim të ndryshëm nga sa është komunikuar në rrugë elektronike, nga ana e administratës së KQZ-së, kështu që të vazhdojmë!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Kaziaj! Duke qenë që dhe anëtarët e Komisionit Rregullator nuk kanë diçka për të diskutuar lidhur me projektvendimin, i ftoj kolegët të votojmë në parim projektvendimin.

Kush është dakord, ju lutem?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet në parim projektvendimi!

Kalojmë nen për nen, ose pikë për pikë. Projektvendimi ka tre pika. Ndryshimet janë të parashikuara në pikën e parë. Pika e dytë është hyrja në fuqi dhe pika e tretë, ankimi në Kolegjin Zgjedhor. Nuk besoj se ka nevojë ta lexoj përmbajtjen sepse u sqarua dhe nga Sekretari i Përgjithshëm, cilat janë dy shtesat. Germa "a" dhe germa "b" në pikën 1, për ndryshimet në nenin 5, ose shtesat më mirë të themi, në nenin 5 dhe nenin 10 të udhëzimit. Atëherë, ftoj kolegët për të votuar pikën 1 të projektvendimit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.01.2022*

Me 5 vota pro miratohet!

Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve!

Kush është dakord me pikën 2?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Pika 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Votojmë në tërësi projektvendimin, "Për disa shtesa në udhëzimin nr. 2, datë 5.12.2020 i Komisionit Rregullator, "Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe të trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në KZAZ dhe KQV".

Kush është dakord, kolegë?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet në tërësi projektvendimi!

Vendimi nr. 3

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



25.01.2022
Ora 16:15

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për një shtesë në vendimin nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”.

PJESËMARRJA :


KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-----------|--------------------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y. Merkaj, M. Koja, A. Tahiraj |
| Parti | Politike: | PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj) |
| OJQ: | | KRIK |

Znj. I. Nano: Pika dytë e rendit të ditës, është gjithashtu një shtesë në vendimin nr.5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”. Edhe kjo shtesë në fakt është e diktuar nga një vendim i mëhershëm, vendimi nr. 1 i Komisionit Rregullator, i marrë para disa ditësh, në të cilin është parashikuar një afat i ndryshëm ankimi në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, kundër vendimeve të KZAZ-së. Pra, afati i rregullt është tre ditë. Në rastin e zgjedhjeve të pjesshme dhe të parakohshme ne e kemi përcaktuar

Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.01.2022*

këtë afat prej 24 orësh dhe mesa duket ky ndryshim ka diktuar dhe këtë propozim, gjithsesi të dëgjojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, zoti Merkaj!

Z. Y. Merkaj: Komisioni Rregullator me vendim nr. 5, datë 20.11.2020 ka miratuar rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Administrimit të Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe në nenin 25, pika 1 të tij, ka përcaktuar të drejtën e ankimit kundër vendimeve të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor për çdo parti politike pjesëmarrëse ose jo, e një koalicioni, si dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit, duke përcaktuar si afat ankimi në zgjedhjet e zakonshme ose normale, një afat tre ditor. Duke qenë se jemi në zgjedhjet e pjesshme dhe të parakohshme që ky afat i ankimit duhet të jetë më i vogël, pasi dhe afatet janë më të shkurtra, kemi paraqitur propozimin për të shtuar një fjali në fund të pikës 1, të nenit 25. Konkretisht “për zgjedhjet e parakohshme dhe/ose të pjesshme afati i ankimit tre ditë i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, të bëhet 24 orë”. Pra, të shkurtohet nga tre ditë në 24 orë. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Çelim diskutimin në parim. Kolegët, anëtarët e komisionit, përfaqësuesit e partive politike? Nuk kanë gjë, atëherë kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)


Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet!

Kalojmë në miratimin e secilës prej 3 pikave të projektvendimit.

Pika 1. Në fund të pikës 1 të nenit 25, të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe

*Zbardhi materialin audio
Merija DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.01.2022*

funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, shtohet fjalia me këtë përmbajtje “për zgjedhjet e parakohshme, dhe/ose të pjesshme, afati i ankimit tre ditë, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni bëhet 24 orë”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet!

Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Votojmë, ju lutem, kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet pika 2!

Pika 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet pika 3!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit, pasi e kemi votuar në parim dhe nen për nen. Ju lutem kolegë, të votojmë në tërësi projektvendimin!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet vendimi “Për një shtesë në vendimin nr. 5, datë 20.11.2020 i Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullore për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”.

Vendimi nr. 4

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**25.01.2022
Ora 16:19**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e udhëzuesit të punës për komisionet e zonave të administrimit zgjedhor, për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-------|--------------------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y. Merkaj, M. Koja, A. Tahiraj |

Parti Politike: PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)

OJQ: KRIK

Znj. I. Nano: Në rendin e ditës kemi për shqyrtim dhe miratim projektvendimin “Për miratimin e udhëzuesit të punës për komisionet e zonave të administrimit të zgjedhjeve për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022”. Sikundër edhe në zgjedhjet e kaluara dhe në çdo zgjedhje, trajnohen para zgjedhjeve, zhvillohen trajnimet lidhur me komisionet e zonave të administrimit zgjedhor dhe vlerësohet i nevojshëm një udhëzues pune, i cili sot na ka ardhur për shqyrtim dhe miratim. Duke qenë që edhe ky projektvendim është propozim i

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.01.2022*

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Zoti Merkaj, ju lutem një përmbledhje të projektvendimit!

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 20 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Rregullator shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitur nga administrata e KQZ-së, udhëzuesit doracakë të shërbimit të administratës zgjedhore, subjektet zgjedhore dhe zgjedhësve. Duke referuar nenin e mësipërm kemi përgatitur dhe i paraqesim Komisionit Rregullator projektudhëzuesin e punës për Komisionin e Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022. Ky udhëzim, ose udhëzuesit janë në mbështetje të Komisionit të Administrimit të Zonës Zgjedhore, si materiale në ndihmë të tyre. Detyrat e KZAZ-së janë përcaktuar në Kodin Zgjedhor dhe në aktet e tjera të dala në zbatim të kodit. Qëllimi i këtij materiali është lehtësimi i punës së KZAZ-ve duke përshtatur afatet dhe përmbushjen e detyrave të tyre. Në këtë janë caktuar parimet e rregullave të etikës, në të cilat mbështetet KZAZ-ja. Udhëzimi është i konkretizuar me parashikimet e zgjedhjeve të pjesshme të datës 6 Mars 2022, duke përcaktuar 13 KZAZ-të që përfshihen në proces në 6 bashkitë ku do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme vendore. Në udhëzim trajtohen KZAZ-të në të cilat kryhet regjistrimi i komitetit nismëtar, si dhe afati i shqyrtimit të kërkesave të këtyre komiteteve. Detyrat e KZAZ-së, të kryetarit dhe sekretarit janë dhënë të ndara për të lehtësuar punën e tyre. Vendimmarrja, mbledhjet si dhe detyrat e ankimit ndaj vendimeve të tyre është përshtatur me afatet e përcaktuara për zgjedhjet e pjesshme. Po kështu janë trajtuar dhe detyrat e KZAZ-së, lidhur me vëzhguesit dhe detyrat e saj për ngritjen e Komisionit të Qendrës së Votimit, si dhe procedurat që ndjek për shpërndarjen e materialeve zgjedhore. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe udhëzuesin, të cilin sapo e relatova, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.01.2022*

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Sikundër ju theksuat është një udhëzues i cili vjen në ndihmë të anëtarëve të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, në përmbushje të detyrimeve të tyre në procesin zgjedhor të datës 6 Mars 2022, për zgjedhjet e pjesshme në 6 bashki të vendit, sipas dekretit të Presidentit të Republikës. Çelim diskutimin në parim për projektvendimin. Kolegët më tej dhe përfaqësuesit e partive politike. Kolegë, së pari, keni ndonjë çështje për të diskutuar në parim? Përfaqësuesit e partive politike?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zonja Nano! Ne jemi njohur me projektvendimin edhe me udhëzuesin e punës, i cili sigurisht vlerësojmë që është një dokument shumë i rëndësishëm, duke qenë se brenda dy ditëve do të ngrihen dhe KZAZ-të, në mënyrë që të udhëzohen. Kisha vetëm një pyetje për administratën, ose dhe për komisionin. Shoh që në udhëzues është përcaktuar që qendrat e votimit do të hapen në orën 7 të mëngjesit dhe do të mbyllen në 7 të darkës, domethënë është përcaktuar tashmë që ky do të jetë orari zyrtar i çeljes së votimit dhe mbylljes në orën 7.

Znj. I. Nano: Një moment më vonë, sepse kur të kalojmë nen për nen, kjo është pjesë e diskutimit të përmbajtjes së udhëzuesit, që është pika 1. Kështu që vetëm në parim diskutimi. Sapo të diskutojmë përmbajtjen e udhëzuesit, ju lutem administrata të mbajë shënim pyetjen e zotit Logu për t'ju përgjigjur kur të vijë momenti. Zoti Kaziaj!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Nuk kemi ndonjë gjë në parim!

Znj. I. Nano: Në rregull, faleminderit! Votojmë në parim projektvendimin për miratimin.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.01.2022*

Në parim kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Administrata keni nevojë për pak pushim, keni ndonë sqarim për të bërë?

Z.Y.Merkaj: Jo, thjesht konstatuam se te projektvendimi, pika 3 është shënuar, “kundër vendimit të komisionit”, është lapsus, “brenda 24 orëve bëhet ankim në KAS”. Është gabim që na ka shpëtuar, kërkojmë ndjesë, nuk do përsëritet më, por që isha i detyruar ta thoja.

Znj. I. Nano: Në projektvendim, në tekstin e projektvendimit?

Z. Y. Merkaj: Po! Ndërsa për pyetjen që bëri përfaqësuesi i Partisë Demokratike, është neni 11 i Kodit Zgjedhor. Orari i votimit është afat ligjor, ku caktohet në periudhën 15 prill deri në 15 maj, qendra votimit hapet në orën 7 të mëngjesit dhe mbyllet në orën 19 të mbrëmjes.

Znj. I. Nano: Në rregull, faleminderit!


Z. M. Çakaj: Domethënë është periudha më e afërt? Sepse 6 marsi i bie jashtë afatit?

Znj. I. Nano: Po pra! Është më afër me periudhën e cila ka këtë orar votimi!

Z. M. Çakaj: Pra, është më e afërt me periudhën zgjedhore?

Z. Y. Merkaj: Po! Sepse është 15 prilli!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Z. M. Çakaj: Periudhë zgjedhore, sepse 6 marsi i bie jashtë?

Z. Y. Merkaç: Po!

Znj. I. Nano: Mirë atëherë, fillojmë me diskutimin nen për nen, ose pikë për pikë. Pika e parë, është miratimi i udhëzuesit. Atëherë vijmë tek përmbajtja e udhëzuesit. Personalisht kam një korrigjim të vogël dhe një propozim. Ndërkohë kolegët çfarëdo që mund të kenë... Për administratën, se nuk kemi dhe numërtimin e faqeve, pas pjesës “pa saktësitë në listën e zgjedhësve” në dy, duhet vënë numërtimi njëherë, e para. Kemi pjesën “vëzhguesit”, tek tabela e dytë thuhet “kundër vendimit të KZAZ-së për refuzimin e kërkesës për akreditim mund të bëhet ankim në KAS brenda tre ditëve”. Thjesht duhen reflektuar këto ndryshime që ne kemi bërë. Pra, brenda 24 orëve, kështu që këtë nuk e konsideroj propozim, por thjesht një saktësim edhe vendimi që sapo morëm për rregulloren e KZAZ-së, ndryshimin e rregullores. Ndërkohë në pjesën, “ndërveprimi i KZAZ-së me Policinë e Shtetit”. Keni dy tabela kur fliten për detyrat e kryetarit të KZAZ-së, i cili është përgjegjës për të njoftuar shefin e komisariatit të policisë të njësisë së vetëqeverisjes vendore për vendndodhjen e KZAZ-së dhe orarin e punës së saj. Gjithashtu dhe për të dërguar grafikun e punës së KZAZ-së, të firmosur nga kryetari dhe zëvendëskryetari. Në zgjedhjet e kaluara kemi parashikuar një afat njëjavor për të përmbushur këto detyrime, qoftë kryetari i KZAZ-së, dhe së dyti bashkë me zëvendëskryetarin. Kështu që mendoj kolegë, që ne duhet të vendosim një afat edhe këtu, në mënyrë që detyrat të jenë të mirëpërcaktuara. Personalisht propozoj të njëjtin afat që kishim dhe për zgjedhjet e kaluara, një javë. Më rezulton 28 shkurti, ose 27 shkurti. Megjithatë, ky afat të paktën nga përvoja e zgjedhjeve lidhet me veprimtarinë e KZAZ-së javën e fundit para zgjedhjeve,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.01.2022*

dërgimin e materialeve zgjedhore, e të tjera. Kështu që unë propozoj në këto dy pika, datën 28 shkurt. Pra, në datën 28 shkurt apo brenda datës 28 shkurt, më mirë. Do të doja të pyesja administratën nëse këto afate janë...

Znj. H. Vukaj: Më fal! A konsiderohet afat racional apo thjesht do të shkojmë për inerci të parimit apo rregullit që vendosëm në zgjedhjet e kaluara? Si e shihni?

Znj. I. Nano: Po, zonja Tahiraj!

Znj. A. Tahiraj: Praktikisht me atë logjikë kemi ecur. Domethënë kemi lënë afatin njëjavor për njoftimin nga KZAZ-ja të shefit të komisariatit, si dhe hartimin e grafikut. Pikërisht sepse atëherë është edhe periudha kur KZAZ-të fillojnë e marrin materialet dhe si arsyetim kjo ka qenë, domethënë i jemi referuar pikërisht kësaj periudhe njëjavore.

Znj. H. Vukaj: Në tkurrje të afateve që bëhen përgjithësisht, ndaj lindi natyrshëm pyetja që, a janë marrë në konsideratë që çdo gjë të jetë në përputhje edhe me afatet e shkurtuara të çdo etapë? Pra, është ekuivalente me nevojën për t'i shërbyer kësaj faze të procesit?

Znj. A. Tahiraj: Po! Të gjitha afatet e tij kanë qenë brenda edhe aktit që doli për përcaktimin e afateve, kështu që ato janë reflektuar.

Znj. I. Nano: Atëherë, ky është një propozim i imi, propozime të tjera lidhur me përmbajtjen e udhëzuesit? Zoti Çaka!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.01.2022*

Z. D. Çaka: Faleminderit! Në faqen 11 në mos gaboj, ose në faqen 10 më saktë, janë detyrat e KZAZ-së dhe në krah është një tabelë ku janë dhe afatet. Në faqen 11 është përcaktuar një afat, ku thuhet “me kërkesë të zgjedhësve, KZAZ-ja lëshon vërtetim, nëse emri i zgjedhësit ndodhet ose nuk ndodhet në listën përfundimtare të zgjedhësve” dhe afati është vendosur data 3 mars, pra i bie dita e enjte. Unë do të propozoja që të kishim një spostim të kësaj date, pra të ishte data 4 mars, duke pasur parasysh që në referim të Kodit Zgjedhor afati për të depozituar kërkesën në gjykatë është 24 orë para datës së zgjedhjeve. Kjo do t’i jepte një mundësi të gjithë atyre zgjedhësve që ose nuk do të gjenin emrin në listë, ose një nga përbërësit zgjedhorë mos të ishte i saktë, të merrnin këtë vërtetim dhe ta përdornin dhe si dokument për në gjykatë. Kështu që do të propozoja që data 3 mars në këtë pikë të bëhej 4 mars 2022, pra të shtyhej me një ditë.

Znj. I. Nano: Pra, që të merrej në aftin maksimal të mundshëm para...

Z. D. Çaka: Pra, të ishte afati maksimal i mundshëm përpara kërkesës për t’iu drejtuar gjykatës.

Znj. H. Vukaj: Mos biem ndesh me fleksibilitetin që të jep platforma e-Albania, ku t’i arrin të aksesosh dhe të nxjerrësh certifikatën e duhur.

Z. D. Çaka: Këto janë vërtetimet që merren nga KZAZ-ja, duke iu referuar dhe eksperiencës së viteve të kaluara dhe 25 prillit, afati që kemi vendosur me akt, ka qenë data 23 prill, pra ka qenë dita e premte, dita e fundit që mund të lëshoheshin këto vërtetime.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.01.2022*

Znj. I. Nano: Po i drejtohem administratës për faktin se kanë parashikuar datën 3 mars. Si është menduar nga ana e tyre kjo gjë?

Z. Y. Merkaj: Dhe data 4 mars mund të vendoset!

Znj. I. Nano: Kemi dy propozime për ndryshime në tekstin, përveç atyre dy saktësimeve. Propozime të tjera për ndonjë ndryshim të mundshëm? Kolegët, përfaqësuesit e partive politike? Atëherë, kalojmë në votimin e propozimeve? Po marr së pari propozimin e zotit Çaka, duke qenë që është në radhë më herët këtu në udhëzues. Pra, në pjesën, “detyrat e KZAZ-së lidhur me kërkesën e zgjedhësve, ku KZAZ lëshon vërtetim nëse emri i zgjedhësit ndodhet apo nuk ndodhet në listën përfundimtare të zgjedhësve, propozohet të bëhet deri më 4 mars”.

Kush është dakord, ju lutem, kolegë?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Atëherë, miratohet ky ndryshim!

Ju lutem administrata të mbajë shënim ndryshimet. Në pjesën “ndërveprimi i KZAZ-së me Policinë e Shtetit”, të vendoset afati 28 shkurt, qoftë për njoftimin e shefit të komisaritit për vendndodhjen e KZAZ-së, qoftë për dërgimin e grafikut të punës së KZAZ-së të firmosur nga kryetari dhe zëvendëskryetari, data 28 shkurt, duke ruajtur formulimin e udhëzuesit të vjetër pra, nëse është brenda datës, ose deri në datën 28 shkurt.

Kush është dakord ju lutem me këtë propozim, kolegë?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet!

Atëherë miratojmë pikën 1 të projektvendimit me këto dy ndryshime që është, “Miratimi i udhëzuesit të punës për komisionet e zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022”.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Pika e dytë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Pika 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kolegë, kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Miratojmë në tërësi projektvendimin. Kërkoj dhe njëherë të shprehen kolegët për dakordësinë ose jo.

Kush është dakord me projektvendimin në tërësi?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Lidhur me projektvendimet që sapo miratuam. Lutem administratës zbardhjen në një kohë sa më të shpejtë dhe publikimin e tyre, duke qenë se jemi në këto zgjedhje me afate shumë të ngushta. Faleminderit! Mbledhjen e deklaroj të mbyllur!

Vendimi nr. 5

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

